

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P. 132/14

Mitrovicë, 30 korrik 2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, me Trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it, Vidar Stensland, si Kryetar i trupit gjykues, Gjyqtari i EULEX-it, Dariusz Sielicki dhe Gjyqtarja e EULEX-it, Katrien Gabriel Witteman, me këshilltarin ligjor të EULEX-it, Dukagjin Kërveshi, si zyrtar regjistruar në çështjen penale kundër:

G. G., emri i babës M., i lindur me _____, në _____, para se të paraburgosej ka banuar në fshatin _____, Komuna e _____, qytetar i Republikës së Kosovës, me numrin e letërnjoftimit _____.

I pandehuri ishte akuzuar përmes Aktakuzës së EULEX-it, Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, data, 14 nëntor 2014 (me qartësimin, data 08 dhjetor 2014) me veprën penale të:

“Të premtën më 22 mars 2013, aty rreth orës 13:50, në rrugën :”Arsim Muzaqi”, në Vushtrri, duke vepruar në bashkëveprim me persona të tjerë, tani të ndjerin B. G. dhe të miturin I. G., kanë marrë pjesë dhe kryesisht kanë kontribuar në vrasjen e viktimës Xh. K., si rezultat i përdorimit të armës së zjarrit. Prandaj, i pandehuri G. G. ka kryer veprën penale të Vrasjes së rëndë, në kundërshtim me nenin 179, paragrafin 1, nën paragrafët 1.5 dhe 1.8, në lidhje me nenin 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.”

Shqyrtimi kryesor, e hapur për publikun, ishte mbajtur më 30 qershor, 2, 9, 24 dhe 28 korrik 2015 me praninë e të akuzuarit dhe të avokatit të tij mbrojtës, Mahmut Halimi dhe të Prokurores së Eulex-it, Lily Oprea Stelluta. Më 24 korrik 2015, Prokurori publik i EULEX-it, Tomas Skala ka zëvendësuar Stellutën. Pala e dëmtuar, Q. B. (e veja e të ndjerit Xh. K.) ishte e pranishme më 30 qershor dhe 02 korrik 2015.

Paneli ka shqyrtuar dhe votuar më 28 korrik 2015.

Në pajtim me nenin 366, paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)¹ më 30 korrik 2015 në seancën publike dhe në praninë e të akuzuarit, avokatit të tij mbrojtës dhe të Prokurorit të EULEX-it.

¹ Numri Penal 04/L-123

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P. 132/14

Mitrovicë, 30 korrik 2015

Gjykata vendos sikurse më poshtë:

AKTGJYKIM

I. I akuzuari G. G.

Shpallet fajtor dhe dënohet

Për veprën penale të:

Vrasjes së rëndë - neni 179, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës²

Sepse

Të premten më 22 mars 2013, rreth orës 13:50, në rrugën Arsim Muzaqi, në Vushtrri, G. G. ishte duke e vozitur veturën Golf II, me ngjyrë të kuqe, me numër regjistrimi _____. B. G. ishte i ulur në ulëse e parë të pasagjerëve. Ata e kanë parë Xh. K. duke u afruar nga ana e kundërt e rrugës me veturën Mercedes, ngjyrë të kaltër me numër të regjistrimit _____. G. G. ka ndalur veturën Golf dhe B. G. ka dal nga vetura jashtë. B. G. eci në drejtim të veturës Mercedes deri sa G. G. e ktheu veturën Golf në shtegun e djathtë të rrugës duke e bllokuar rrugën për veturën Mercedes. B. G. nxori revolen e tij, _____ deri sa ecte në drejtim të veturës Mercedes. Ai hapi derën e përparme të vozitësit të Mercedesit dhe shtiu në drejtim të Xh. K.. E qëllloi dhe goditja shkoi përmes krahut të majtë dhe pastaj hyri në pjesën e majtë të krahavorit të tij. Xh. K. vdiq më vonë atë ditë si rezultat i lëndimeve të shkaktuara nga e shtëna me armë të zjarrit nga B. G.. Pas kësaj të shtëne, B. G. shkoi pas Mercedesit dhe qëllloi dy herë që kaluan përmes mbështetëses së prapme të kokës së veturës Mercedes dhe përfundojë në ulëset e prapme.

Xh. K. kishte revole _____ në veturën e tij (Mercedes) dhe ai shtiu katër herë. Dy nga këto të shtëna e qëlluan B. G.. Një plumb e goditi B. G. në anën e majtë të abdomenit dhe doli jashtë në anën e kundërt. Plumbi i dytë e qëllloi B. G. në pjesën e përparme të gjoksit, gati në

² Tani e tutje KPRK.

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P. 132/14

Mitrovicë, 30 korrik 2015

vijën e mesme. Gjithashtu edhe gishti i mesëm i dorës së majtë të B. G. ishte i këputur si rezultat i sulmit nga njëri nga dy plumbat.

Pasi që G. G. e bllokoi rrugën për veturën Mercedes, ai menjëherë la veturën Golf, vrapoi në drejtim të veturës Mercedes dhe e hapi derën e përparme të pasagjerit.

G. dhe B. G. vepruan së bashku. Ata e panë se Xh. K. erdhi në drejtimin e tyre me veturën Mercedes dhe vendosën që ta sulmojnë atë. G. G. kontribuoi kryesisht duke e bllokuar rrugën për Mercedesin, duke e detyruar Xh. K. që të ndalej, që e bëri të mundur për B. G. të hap derën e përparme të derës së vozitësit dhe ta qëllloi Krasniqin. Për më shumë, G. G. ka kontribuar duke vrapuar tek vetura Mercedes, duke e hapur derën e përparme të pasagjerit duke e penguar Xh. K. në veprimin e tij defensivë.

Trupi gjykues nuk mendon se është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se G. G. ka vepruar me dashje të drejtpërdrejt kur vije tek vrasja. Trupi gjykues, sido që të jetë, mendon se është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar se G. G. ka vepruar me dashje eventuale. G. G. ishte i vetëdijshëm se ai dhe B. G. vendosën që ta sulmojnë Xh. K.. Ai e dinte se veprimi i tij, vozitja e veturës Golf, bllokimi i rrugës për Xh. K. në veturën Mercedes duke e penguar Xh. K., së bashku me veprimin e B. G., mund të çonte tek vrasja e Xh. K.. Dhe përsëri ai vendosi që të kontribuoj në sulmin e B. G. kundër Xh. K.

G. G. mendërisht ishte kompetent ku e bëri krimin.

Në kohën e të shtënave kishte disa njerëz që ecnin përgjatë rrugës “Arsim Muzaqi”, afër vendit të krimit. Dy persona ishin brenda dyqanit të qebapëve “Te Bajrami”, gjithashtu afër vendit të krimit. Një nga të shtënat i kryer nga Xh. K. hyri në dyqanin e qebapëve përmes dritares karshi rrugës, kështu duke e rrezikuar jetën e personave brenda. B. G. gjuajti dy herë nga ana e prapme e veturës Mercedes. Ai ishte në situatë të tensionuar pa kontroll të veçantë mbi armën e tij. Ishte e rastësishme se dy plumba kishin qëlluar karrigen e prapme të veturës Mercedes dhe jo një apo më shumë persona jashtë veturës Mercedes. G. G. e dinte se sulmi kundër Xh. K. mund të rezultonte në luftë armësh dhe të rrezikonte jetën e një apo më shumë personave, por ai përsëri vendosi të marr pjesë në sulmin kundër Xh. K.

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P. 132/14

Mitrovicë, 30 korrik 2015

Trupi gjykues nuk mendon se është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar se Xh. K. ishte privuar nga jeta e tij për shkak të hakmarrjes së paskrupullt apo duke u bazuar në motive të tjera.

II. I akuzuari G. G. me anën e kësaj

Dënohet

Me **15 (pesëmbëdhjetë) vite burgim**, në pajtim me nenin 179, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 dhe nenin 31, të KPRK-së.

Koha e mbajtjes në paraburgim që nga 19 shtatori 2014 përfshihet në dënim me burg, në pajtim me nenin 365, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5, të KPK-së.

III. Konfiskimi

Revolja e përdorur nga B. G., _____ është konfiskuar në pajtim me nenin 69, paragrafin 1 dhe nenin 365, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4, të KPK-së.

IV. Shpenzimet procedurale

I akuzuari G. G. do të paguaj 300 euro si pjesë e shpenzimeve procedurale, por lirohet nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të mbetura në pajtim me nenin 453, paragrafëve 1 dhe 4, të KPK-së. I akuzuari G. G. duhet që të bëjë kompensimin e shumës së urdhëruar jo më larg se 30 ditë nga dita e kur Aktgjykimi merr formën e prerë. Çdo shpenzim i mbetur do të paguhet nga burimet buxhetore.

Gjyqtari i EULEX-it Kryetari i trupit gjykues i EULEX-it Gjyqtarja e EULEX-it

Darius Sielicki

Vidar Stensland

Katrien Gabriel Witteman

Këshilla ligjore:

Palët kanë të drejtë që të ankohen kundër këtij Aktgjykimi brenda 15 ditëve nga data e pranimit të Aktgjykimit që është dhënë në pajtim me nenin 380, paragrafin 1, të KPK-së.